



PRANUAR MË:  
ACCEPTED ON: 02/04/2026  
PRIMLJENO:  
01/592



REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna Malishevë

Në mbështetje të nenit 10,16 , 58, 68 paragrafi 68.3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L - 040 , Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës , nr.28 , nenit 12 dhe 22 të Rregullores së MF , nr.04 / 2017 mbi Kriteret , Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ - ve , nenit 17 të Rregullores komunale për Subevncione dhe Transfere, nr.12/236, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në bashkëpunim me zyrën e kryetarit të Komunës së Malishevës, bëjnë këtë:

### THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM

Ftohen Organizatat joqeveritare (klubet sportive) të rexhistruara në Republikën e Kosovës, që janë aktive dhe zhvillojnë aktivitetet e tyre në Komunën e Malishevës, se mund të aplikojnë me projektet e tyre për përkrahje financiare nga Komuna e Malishevës për vitin 2026.

Gjithëashtu, ftohen individët që të aplikojnë me projekte në fushën e kulturës dhe rinisë.

Shuma financiare për thirrjen publike është 50.000.00 €.

Mbështetja financiare do të ofrohet varësisht nga vlerësimi i projektit nga komisioni dhe mundësitë buxhetore të Komunës së Malishevës. Shuma minimale për projekt/propozimet është 500.00 €, kurse shuma maksimale për projekt/propozimet është 10,000.00 €.

OJQ-të (klubet sportive) në përputhje me këtë thirrje publike, mund të aplikojnë me projektet në lëmin e sportit si dhe sipas shpenzimeve të pranura për aktivitete zyrtare, si në vijim:

Mbështetje financiare për mbulimin e shpenzimeve në referim për aktivitetet zyrtare, asistimin e policisë gjatë aktiviteteve zyrtare, ekipet mjekësore gjatë aktiviteteve zyrtare, transport për aktivitete zyrtare dhe stërvitje, ushqim për aktivitete zyrtare, ushqim shtesë për sportistët elitar, vitamina, fizioterapi, rekuizita sportive, kampet stërvitore brenda dhe jashtë vendit, regjistrim dhe kuotizim në federatën përkatëse, avancimin dhe masovizimin e sportit përkatës, afirmimin dhe zbulimin e talentëve të rinj në sport në komunën e Malishevës, krijimet letrare për idnivid, aktivitetet rinore, ekspozit artistike (Piktur) për rinjë.

#### Dokumentet e kërkuara për aplikim për OJQ:

1. Projektpropozimi i plotësuar sipas formularit të kërkuar duke përfshirë qëllimin, agjendën, aktivitetet vjetore;
2. Buxheti i projektit i plotësuar sipas formularit të kërkuar;
3. Certifikata e regjistrimit e OJQ-së;
4. Certifikata e numrit fiskal e OJQ-së;
5. Dëshmi se OJQ-ja nuk ka obligime ndaj ATK - së (Vërtetim nga ATK);
6. Konfirmimin nga banka për xhironlogarinë e aplikuesit;
7. Kopje e letërnjoftimit/pasaportës të përfaqësuesit të OJQ-s;
8. CV-ja e menagjerit të projektit;
9. Vërtetim i rexhistrimit të klubit në Federatë ku përfshihen të arrituarat e vitit paraprak dhe rangui i garave;

**Dokumentet e kërkuara për aplikim individ:**

1. Projektpropozimi i plotësuar sipas formularit të kërkuar duke përfshirë qëllimin, agjendën, aktivitetet vjetore;
2. Buxheti i projektit i plotësuar sipas formularit të kërkuar;
3. Konfirmimin nga banka për xhironlogarinë e aplikuesit;
4. CV-ja e menagjerit të projektit;

OJQ-të (klubet sportive) mund të aplikojnë vetëm në një projekt që kontribon në avancimin e sportit në Komunën e Malishevës.

Të drejtë aplikimi kanë OJQ-të (klubet sportive) të rexhistruara në Republikën e Kosovës, që veprojnë në Komunën e Malishevës para dates së publikimit të thirrjes publike dhe që dëshmojnë se aktiviteti i tyre është në fushën e sportit dhe individët nga kultura që veprojnë në Komunën e Malishevës.

**Mënyra e aplikimit:**

Dorëzimi i aplikacionit bëhet në zarf të mbyllur. Brenda zarfit vendosen 2 kopje të të gjithë dokumentacionit origjinal. Dokumentacioni dorëzohet në zyrën e pranimi në objektin e komunës, në sportelin e qendrës për shërbime për qytetarët.

Formulari i aplikimit dhe formulari financiar mund të shkarkohet në webfaqen e Komunës:

<https://malisheve.rks-gov.net>

Aplikacionet e dërguara pas mbylljes së afatit si dhe aplikacionet e pakompletuara sipas kritereve të përcaktuara në këtë thirrje do të refuzohen.

Thirrja publike për aplikim hapet nga data 02.04.2026 dhe mbyllet më 27.04.2026 në orën 16:00.

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: [dkrs.malisheva@gmail.com](mailto:dkrs.malisheva@gmail.com).

**Kryetari i Komunës së Malishevës**  
**Ekrem Kastrati**

